



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SHPRESA GJOCI  
ADRESA NJESIA AMDINISTRATIVE  
NR. 5,  
TEL: 0682071706

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 4141

Tirane më 12/05/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2022053920142546829

DATE 12/05/2022  
NR REP 4141

### VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 12.05.2022 (dymije e njetete e dy), para meje Notere SHPRESA GJOCI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA AMDINISTRATIVE NR. 5, , u paraqit personalisht:

#### DEKLARUES/IT:

Ingrid Gostivari, atësia Rifat, amësia Lumturi Nadire, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Sulejman Delvina; Nd. Pall.63/1; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 29/12/1967, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037121180 dhe nr. personal G762290261, . .

#### DEKLARUES/IT:

Estela Vlashi, atësia Sherif, amësia Hysmete, shtetase Shqiptare, lindur në Maminas, Durrës dhe banues në TIRANË, me adresë Rrapo Hekali 03910112; Nd. 13; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 13/06/1980, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033622177 dhe nr. personal I05613186L, . .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Dokument bashkëlidhur STATUT "La Griffe Academy" sh.p.k

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

SHPRESA GJOCI



**STATUTI**  
**LA GRIFFE ACADEMY SH.P.K.**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më **09 Maj 2022**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **La Griffe Academy sh.p.k.** që këtu e më tutje do të quhet Shoqëria.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

**Znj. Estela Vlashi** (emri i babait Sherif, emri i nënës Hysmete, lindur në Maminas, Shqipëri më 13 Qershor 1980 rezidente në adresën: Kodra e Diellit, Pallati Top Hill, Apartamenti 62/2, Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare, mbajtëse e pashaportës me nr. BJ6587158 dhe datë lëshimi 01.11.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë.

**Znj. Ingrid Gostivari** (emri i babait Rifat, emri i nënës Lumturi, lindur në Durrës, Shqipëri më 29 Dhjetor 1967 rezidente në adresën: Rr Sulejman Delvina, Ndërtesa 63/1, Apartamenti 62/2, Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare mbajtëse e Kartes se Identiteti me nr. 037121180 dhe datë lëshimi 03.04.2021 nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2:**

**Objekti i veprimtarisë:**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë aktivitetet e mëposhtme:

- Shkollë mode dhe dizajni ku perfshihet: edukim dhe arsim profesional, trajnim për përvetësimin e aftësive profesionale të zhanreve të ndryshme në fushën e modës duke përfshirë, por pa u kufizuar në: stilim veshjesh dhe aksesorësh, dizenjim mode për/dhe tekstile, arredim ambjentesh të ndryshme, modelim, menaxhim biznesi në fushën e modës, komunikim në fushën e modës me kurse përgatitore mbi stilin, kulturën dhe gjuhën italiane dhe angleze të modës, përgatitje modelesh për sfilata etj, si dhe ri-trajnim profesional për drejtim arti mode, dizajn ateliesh, dizajn komunikimi digital etj. Konsulencë në fushën e stilit, përgatitje stafi për modelim etj. Dizajn produktesh luksi, Dizajn i këpucëve dhe aksesorëve. Kurse profesionale si: Menaxhimi i shitjeve me pakicë online; Menaxhimi i dyqanit online; Teknik koleksionesh, teknik konfeksionimi, teknik modelist, konsulent imazhi, etj.
- Aktivitet në fushën e trajnimit profesional ne lidhje me modën, duke përfshirë por pa u kufizuar në menaxhim mode me kurse mbi teknikat aktruese dhe të moderimit/prezantimit në televizion, kinema, reklama dhe mediat dixhitale; teknikat e ecjes, qëndrimin dhe pasarelave, poza fotografike, teknika të sjelljes dhe stilit; look-u dhe make up, kultura e ushqyerjes/dietave, vetëvlerësim dhe motivim; influencer/ndikues; Konsulencë dhe ndërmjetësim, Menaxhimi (modele dhe stilistë), produksione audiovizuale; Prodhimi dhe tregtimi i artikujve të markës; Merchandising, stilim veshjesh dhe aksesorësh, dizenjim veshjesh, aksesorësh dhe interior-design, modeling etj përmes ofrimit të kurseve / klasave me kohëzgjatje nga disa muaj deri ne 3+1 vite. Ofrimin e këtyre kualifikimeve profesionale të njohura ndërkombëtarisht në fushën e modës.

- Organizimi i eventeve, i seminareve të ndryshme, sfilatave të modës ose të cdo lloji tjetër, fletëpalosjeve apo videove të ndryshme që reklamojnë aktivitetin tregtar të kryer nga kjo akademi.
- Akademia bashkëpunon me shtëpi mode kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar dhe ndërmjetësim për punë në shtëpitë ndërkombëtare të modës të top-studentëve të saj, pas përfundimit të trajnimeve përkatëse.
- Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet me të larta të etikës.

### **Neni 3:**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj motivi.

### **Neni 4:**

#### **Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Kodra e Diellit 1, Rruga e Ullinjve, godina Nr.4, Tirane.**
- (2) Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë, zyra perfaqesimi dhe qendra të zhvillimit të aktivitetit kudo brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Selia qendrore e Shoqërisë dhe e qendrave sekondare të zhvillimit të aktivitetit mund të ndryshohet me vendim të Administratorit (ëve).

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

1. Ortaku themelues **Ingrid Gostivari** është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40.000 lekë që përbën **40%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Estela Vlasi** është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 60.000 lekë që përbën **60%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët themelues bien dakort që në krijimin e kësaj shoqërie se nuk do t'i krijojnë pengese shoku-shokut nese ne nje moment duan te terhiqen nga kjo shoqeri, qofte dhe permes shitjes se kuotave personale kundrejt njeri-tjetrit.

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Në shoqërinë **La Griffe Academy sh.p.k.**, Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës në shoqëri.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme do të pranojë vendimarrjen e ortakut me pjesëmarrjen më të madhe të aksioeneve për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Përfundimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortakë përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakë, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**



## **Administrimi**

(1) Shoqëria drejtohet dhe përfaqësohet nga Administratori (et). Administratorët mund të jenë të cdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidentë në Shqipëri Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Administratori i shoqërisë do të jetë zj. **Estela Vlasi** (emri i babait Sherif, emri i nënës Hysmete, lindur në Maminas, Shqipëri më 13 Qershor 1980 rezidente në adresën, Kodra e Diellit, Pallati Top Hill, Apartamenti 62/2, Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare mbajtëse e pashportës me nr. BJ6587158 dhe datë lëshimi 01.11.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë.

Kohëzgjatja e emërimit të Administratorit (eve) është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit), me të drejtë ripërtëritje të këtij afati.

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Administratorit (ëve)**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashkohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asambletë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti Financiar-Ekspertët**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**



## **Fitimet**

Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë detyrimet përkatëse që nevojiten për ushtrimin e aktivitetit, pagesat ndaj të tretëve, si dhe vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor, si dhe 5% (pesë për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa që mbetet pas zbritjes së zërave të mësipërm, do t'u shpërndahet pronarëve të kuotave të kapitalit themeltar përpjestimisht me pjesëmarrjet e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të destinimit të ndryshëm të vendosur nga vetë ortakët.



## **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me plotësisht me kështu statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.  
Përndryshe nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **Neni 22**

##### **Te ndryshme**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislativi tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themeluesë.



**ORTAKËT  
e SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
La Griffe Academy sh.p.k.**

**Estela Vlasi**

*Estela Vlasi*

**Ingrid Gostivari**

*Ingrid Gostivari*